



Takime – Begegnungen von „Artists in Residence“

NRW – Shqiperi

Arti është si një gjuhë ndërkombëtare që nuk njih kufij shtetesh e kombesh. Ai është si urë lidhëse pa zhurmë, e qëndrueshme. Por dhe arti me gjithë bukurinë e pakufinë e tij, ka nevojë si trupi i njeriut të mbartet. Ai kërkon duar të gatshme për ta bërë të transferueshëm dhe guxim e këmbëngulje për ta bërë të dukshëm. Arti nuk është si një thasethem ekzotik që kalon kufijtë në sekonda nëpërmjet rrjeteve sociale, arti është delikat dhe kërkon vëmendje e pasion.

Shqipëria dhe arti i saj si pjesëz e rrjetës së stërmadhe të artit botëror nuk e ka të lehtë të gjejë vendin e saj të meritur dhe të rrugëtojë e të bëhet e prekshme jashtë kufijve të saj. Kështu me mbështetjen proaktive të **Konsullates së Nderit të Shqipërisë** në NRW, **Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë**, së **Ministrisë së Kulturës së Landit të NRW**, **Ambasades së Republikës së Shqipërisë** në Berlin, **Galerisë Kombëtare të Arteve të Shqipërisë**, **Drejtorisë së Kulturës** së qytetit të Düsseldorfit dhe **Shoqatës Integrative Gjermano-Shqiptare – IDEAL**, në kuadrin e programit të bashkepunimit „Artist in Residence“ artisti shqiptar **Eros Dibra** paraqiti punimet e krijuara në qytetin e Düsseldorfit.

Eros është bursist i **Landit të NRW** dhe **Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë**. Ai u perzgjodh nga një juri gjermane mes shumë kandidaturave të tjera dhe do të qëndrojë në kryeqytetin e Landit deri në fund të muajit Mars. Ekspozita e tij „**Plaget – Wunden**“ është e hapur çdo ditë deri me datë **24 Mars**.

Dialogu artistik me Landin e NRW, i iniciuar nga Konsullata e Nderit e Shqipërisë në NRW dhe i formësuar me mbështetjen e **Ministres së Kulturës Znj. Mirela Kumbaro** dhe **Sekretarit të Shtetit të Ministrisë së Kulturës së NRW, Z. Bernd Neuendorf**, gjatë Nëntorit Shqiptar 2015, pritet të pasohet me një shkëmbim talentesh kësaj here në Shqipëri **në vjeshtë të 2016**, ku një artist apo artiste gjermane që do të perzgjidhet nga juria shqiptare do të ketë mundësinë të jetë një **“Artist në Residence” në Shqipëri** dhe të krijojë dhe prezantojë punët në analogji me Eros Dibren!

Suksese **Eros!** Urat e komunikimit tashme janë vendosur!

Ekspozita u organizua nga **Kulturamt der Stadt Düsseldorf** në bashkëpunim me:

